




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 88/15

Nr. i fq. / Br. st -3-

Data: / Datum 30.04.2015

VUSHTRRI - VUÇITRN



**REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI**

**RREGULLORE
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR DHËNIE TË
DEKORATAVE**

PRILL 2015

Bazuar në nenin 12 paragr. 12.1 dhe 12.2 pika (c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 41 paragr.41.2 pika (c) të Statutit të komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **30 prill 2015** aprovoi këtë:

R R E G U L L O R E

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR DHËNIE TË DEKORATAVE

Neni 1 Qëllimi

Me këtë rregullore ndryshohet dhe plotësohet rregullorja për dhënien e dekoratave 01nr.186/13, dt.25.07.2013.

Neni 2 Ndryshimi dhe plotësimi i neneve

1. Neni 4, i rregullores bazë, pika 4.1.8 në vend të fjalës mirënjohje duhet të jetë “çmimi”.
2. Çdo kund ku në rregulloren bazë përdoret fjala “Plaketë” të zëvendësohet me fjalën “Medalje”.
3. Në nenin 6 pika 5, fjala “Fletë mirënjohja” të zëvendësohet me fjalën “Fletëpërcjellja”.
4. Pas paragrafit 6.8 shtohen dy paragrafë të reja me këtë tekst: Titulli “Nderi i Qytetit” mund t’i jepet brenda një (1) viti vetëm një (1) personi.
5. Neni 12 paragr.12.3 rreshti i dytë, në vend të fjalëve “Stema e Komunës së Vushtrrisë” të jetë “Simboli i Penës”.
6. Në fund të nenit 14 shtohet paragraf i ri me këtë tekst: “ përgjatë një date të veçantë nuk mund të ndahen më shumë se 10 mirënjohje apo falënderime”.
7. Pas paragrafit 15.5. shtohen paragrafe të reja si vijon:
 - 7.1. Nëse një personit i ndahet dekoratë, atij nuk i ndahet dekoratë në një rast tjetër me vlerë më të ulët nga dekorata e parë.
 - 7.2. Në rastet kur në ditën e dorëzimit të dekoratës nuk është prezent personi të cilit i dedikohet dekorata apo i afërmi i tij, dekorata ruhet në sekretari deri në 30 ditë. Brenda këtij afati mund të tërhiqet dekorata nga i dekoruari apo i afërmi i tij.

- 7.3. Nëse brenda këtij afati nuk tërhiqet dekorata, ajo i dorëzohet me procesverbal arkivitet të komunës.
- 7.4. Në fund të nenit 15 shtohet paragraf i ri me këtë tekst: “përgjatë një date të veçantë nuk mund të ndahen më shumë se 10 mirënjohje apo falënderime”.
8. Pas pikës 16.5 të nenit 16, të shtohet pikë e re (nr. 16.6) si vijon: Propozimet për dekorata duhet të paraqiten me shkrim së paku 15 ditë para datës në të cilën merret vendimi për ndarje të dekoratës.
9. Përrjashtimisht, në raste shumë të arsyeshme kur në rrethana normale që vlerësohen nga komisioni për dekorata nuk ka qenë e mundur brenda kësaj kohe të jepet propozimi për dekorata, ky afat mund të jetë edhe më i shkurtër, por jo më pak se 24 orë nga dita kur merret vendimi lidhur me dekoratat.
10. Në mbledhjen e kuvendit në të cilën shqyrtohet propozimi i komisionit për dekorata, mund të diskutohen ato propozime, si dhe mund të paraqiten propozime të reja.
11. Në rast se ka më shumë propozime se sa numri i kufizuar i ndarjes së çmimeve, atëherë propozimet iu nënshtrohen votimit të fshehtë në kuvendin e komunës.

Neni 3 **Riformulimi i Titullit ”Qytetar Nderi”**

Neni 5 paragr. 5.1 riformulohet si vijon: “Titulli ”Qytetar Nderi.” është titulli më i lartë që u jepet një personaliteti apo grup personalitetesh njëherit të cilët përfaqësojnë diçka të përbashkët, personalitete këto të shquara politike, shoqërore, shkencëtarëve, shkrimtarëve dhe artistëve vendor dhe ndërkombëtar, në shenjë respekti, miqësie apo mirënjohjeje për kontribute të rëndësishme e të veçanta në fusha të ndryshme në të mirë të qytetarëve të Vushtrrisë.

Neni 4 **Të drejtat e përfituesve të tjerë në raste të veçanta**

Nëse përfituesi i një dekorate (e cila ka edhe shpërblim financiar) nuk është në jetë (ka vdekur), shuma e mjeteve mund t’i ndahet rrethit të parë familjar të përcaktuar në Ligjin e Trashëgimisë.

Neni 5 **Riformulim i Çmimit “Poeteshat Shqiptare”**

1. Neni 10 paragr. 10.1 riformulohet si vijon: “Çmimi “Poeteshat Shqiptare” ju jepet tri poeteshave të cilat janë shpallur nga juria fituese të 3 vendeve të para sipas kësaj radhitje:

1.1. Vendi i parë 500 €;

1.2. Vendi i dytë 300 €;

1.3. Vendi i tretë 200 €.

2. Fshihet paragrafi 10.7. i nenit në fjalë.

3. Te neni 10 shtohet paragrafi i ri me këtë tekst: Çmimi “Debutuesja” t’i ndahet poeteshës e cila merr pjesë për të parën herë dhe është më e reja në moshë. Çmimi shoqërohet me “Fletëpërcjellje” dhe vlerën prej njëqind (100) euro.

Neni 6

Riformulim i Çmimit “Sportisti dhe Sportistja e vitit”

1. Neni 13 paragrafi 1. riformulohet si vijon: Medalja “Sportisti/ja e Vitit” ndahet me rastin e shpalljes së Sportistit/es të Vitit. Kjo medalje u jepet sportistëve të shquar për kontribute të veçanta në lëmin e sporteve.

2. Në raste të këtilla ndahen katër medalje, dhe ate:

2.1. Sportisti i Vitit (për të rritur);

2.2. Sportistja e Vitit (për të rritur);

2.3. Sportisti i Vitit (për të rinjë);

2.4. Sportistja e Vitit (për të rinjë).

3. Në fillim të paragrafit 13.5 fjalët “ çmimi shoqërohet”, duhet të jetë “çmimet shoqërohen”.

Neni 7

Përgjegjës për zbatimin e kësaj Rregulloreje

Për zbatimin e kësaj rregulloreje obligohet Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi tetë (8) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrisë.

Shpëtim Zhegrova



Kryesues i Kuvendit